

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sikagard® PoolCoat

VESHJE ME BAZË UJI PËR EKSPozIM NËN UJË



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sikagard PoolCoat është veshje me ngjyrë e shpërndarë në ujë dhe me bazë rrëshirë akrilike me rezistencë të mirë kundër ujit në një ambalazh.

PËRDORIMET

Si veshje mbrojtëse për rezervuarë betoni, për sipërfaqe të lira mbi beton, llaç çimentoje, panele me fibra çimentoje dhe veshje gome të kloruar, për pishina publike ku trajtimi i ujit bëhet vetëm me klor.

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Rezistencë të lartë ndaj kalcifikimit dhe stabilitet ngjyre
- Rezistencë e shkëlqyer ndaj kremrave dhe vajrave kundër diellit
- Rezistencë e lartë ndaj ujit dhe kimikateve
- Mund të mbulojë veshjet e vjetra ekzistuese prej gome të kloruar
- Pastrohet dhe dezinfektohet lehtë
- Shtim i kohës së mirëmbajtjes

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Ambalazhi	kovë 3 lt., 10 lt.
Ngjyra	Ngjyra pishinash si në katalogun e ngjyrave. White, adriatic blue, lake green, green 21, blue 32. Ngjyra të tjera me porosi. Ndryshimet e lehta të ngjyrave nuk mund të shmangen për shkak të natyrës së lëndëve të para. Ngjyra adriatic blue (pigment organik) mund të pësojë ndryshim të ngjyrës.
Jetëgjatësia	~ 1 vit
Kushtet e magazinimit	Në enën origjinale të pahapur, në mjedis të freskët dhe të thatë. Sikagard PoolCoat duhet të ruhet dhe transportohet pa ngricë.
Dendësia	Në + 23°C rreth 1.32 kg/l
Përmbajtja e substancave të ngurta për peshë	~ 60%
Përmbajtja e substancave të ngurta për vëllim	~ 47%

TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca kimike	Rezistencë ndaj detergjentëve acid dhe alkaline, dezinfektuesve dhe ujit të kloruar sipas rekomandimeve të Sika Deutschland GmbH. Nuk ka rezistencë ndaj tretësve.
--------------------------	--

INFORMACIONE MBI SISTEMIN

Struktura e sistemit

Betoni:

Sipërfaqja e betonit duhet të pastrohet me rrymë uji, që ndiqet nga 2 shtresa niveluese Ilaçi Icoment 520 për parandalimin e flluskave mbi veshjen.

Aplikoni 2-3 veshje Sikagard PoolCoat. Shtoni 5% ujë vetëm për veshjen e parë.

Llaç çimentoje, panele me çimento me fibra:

2 - 3 x Sikagard PoolCoat. Shtoni 5% ujë vetëm për veshjen e parë.

Mbiveshje e veshjeve të vjetra prej gome të kloruar apo veshjeve të tjera të vjetra:

1 - 2 x Sikagard PoolCoat

Polimere:

Sikagard PoolCoat nuk është i përshtatshëm për basene prej polimeresh të përforcuara me fibra qelqi për shkak të rrezikut të krijimit të flluskave ozmotike. Në rast dyshimi, ju lutemi kërkoni këshillat tona të posaçme.

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Konsumimi

Konsumimi

100 g/m²

150 g/m²*

Trashësia e cipës së thatë

36 µm

50 µm

*150 g/m² me 20% humbje për trashësi mesatare të cipës së thatë.

Temperatura e mjedisit

Minimum + 8°C

Maximum + 30°C

Lagështia relative e ajrit

Lagështia e ajrit duhet të jetë më pak se 75 % gjatë gjithë aplikimit dhe kohës së tharjes. Shmangni kondensimin gjatë tharjes (2 ditë) pasi përndryshe do të priten çrregullime gjatë formimit të cipës. Ndotja e ujit gjatë tharjes duhet të largohet menjëherë me fshesë thithëse ose duke përdorur lecka.

Temperatura e nënshtresës

Minimum + 8°C

Maximum + 30°C

Koha e pritjes / mbiveshja

Ndërmjet veshjes fillestare dhe veshjes përfundimtare të paktën 1 ditë (p.sh. 15-20°C). Në temperatura të ulëta (p.sh. 8-12°C) rekomandohet kohë pritjeje ndërmjet veshjeve prej 2 ditësh.

Produkti i aplikuar gati për përdorim

Min. 14 ditë pas veshjes përfundimtare, mundësoni ventilim të mjaftueshëm çdo ditë.

UDHËZIME APLIKIMI

PËRGATITJA E NËNSHTRESËS

Sipërfaqja nuk duhet të ketë kore çimentoje (qumësht) dhe shtresa të tjera pa ndërkapje, grimca të lira, të shkrifëta dhe substanca që shkaktojnë korrodimit.

Kontaminuesit (vaj dhe graso) apo disarmentët, materialet dhe veshjet e vjetra pa ndërkapje dhe pa kompatibilitet.

Sipërfaqet e pastruara duhet nuk duhet të kenë pluhur dhe duhet të jenë të thata.

Për beton me sipërfaqe të dukshme rekomandohet testimi mbi një zonë. Mbikëqyrni përmbytjen e lagështisë.

Për sipërfaqet që janë subjekt i pranisë së përhershme nën ujë, është thelbësor pastrimi me rrymë uji.

Kavitetet, poret dhe çrregullimet e sipërfaqeve të ashpra duhet të nivelohen më parë p.sh. me Ilaçin Icoment 520. Tharja e Ilaçit të imët me p.sh. shtresa jute të lagësht dhe fleta plastike për të paktën 4-5 ditë është tepër e rëndësishme në zonën nën ujë! Veshjet e vjetra: Goma e kloruar e vjetër, e mirëmbajtur dhe plotësisht e pastruar duhet të ashpësohet me bluarje. Në rast dyshimi rekomandohet testimi në terren.

Veshjet e tjera të mirëmbajtura dhe të mirëpastruara si Sikagard PoolCoat nuk është e nevojshme të përgatiten.

PËRZIERJA

Sikagard PoolCoat është gati për përdorim. Produkti duhet të aplikohet i paholluar me përjashtim të veshjes fillestare, e cila mund të hollohet deri në 5% për peshë ujë. Përzieri mirë përpara përdorimit.

METODA E APLIKIMIT / MJETET

Sikagard PoolCoat mund të aplikohet me furçë për fasadat, rul, spërkatje pa ajër, (presioni i pistoletës: ~180 bar, maja: vrimë 0,38 mm-0,66 mm, këndi i spërkatjes: ~40-60°). Në rast aplikimi me rul mbyllja e poreve mund të përmirësohet ndjeshëm nga një aplikim i mëparshëm me furçë.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Me ujë çezme

KUFIZIME

Në rast përqëndrimi të lartë klori-ozoni tek uji (shih DIN 19643-2) ka rrezik për kalcifikim dhe çngjyrosje. Mund të nevojitet një veshje rifreskuese për arsye estetike. Nëse trajtimi ujit bëhet me dezinfektim elektrolize, nuk rekomandohet fare përdorimi i Sikagard PoolCoat.

Shënim:

Çngjyrosja mund të ndodhë nga gjethet dhe petalet. Kundër-masat: Mbulimi, pastrimi.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sikagard® PoolCoat

Mars 2019, Botimi 01.01

020706010010000002

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

MASA PARANDALUESE

- Sikagard PoolCoat nuk është pjesë e rregulloreve për mallrat e rrezikshëm.
- Gjatë aplikimit duhet të kushtohet rëndësi tek udhëzimet e sigurisë mbi etiketë.
- Ju lutemi zbatoni rregulloret lokale.
- Në gjendje të lëngët produkti ndot ujin dhe nuk duhet të hyje nëpër kanale, ujë dhe tokë.
- Në çdo rast mbetjet e holluesit dhe/ose veshjes duhet të asgjësohen në përputhje me ligjin.
- Detaje të metejshme përmbahen tek udhëzimet tona "Ruajtja e shëndetit dhe parandalimi i aksidenteve".

ASGJËSIMI

- Mbetjet e produktit të patharë duhet të asgjësohen sipas ligjit.
- Materiali i tharë mund të asgjësohet si mbetje shtëpiake sipas rregulloreve vendase.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

SikagardPoolCoat-sq-AL-(03-2019)-1-1.pdf



BUILDING TRUST